

REKOMANDIM PËR SHPALLJEN E INFORMACIONEVE ME KARAKTERI PUBLIK TANIMË TË KËRKUARA / PUBLIKUARA NË WEB LOKACIONET E POSEDUESVE TË INFORMACIONEVE

Praktika e mirë konsiderohet kur poseduesit e informacioneve, duke i publikuar në hapësirat e veta të internetit, u vënë në dispozicion të gjithë qytetarëve informatat që janë kërkuar prej tyre, në përputhje me Ligjin për qasje të lirë te informatat me karakter publik.

Në këtë mënyrë, qytetarëve u lehtësohet qasja deri te informatat me karakter publik, pasi që ato mund të arrijnë deri te informatat e kërkuara në një mënyrë më të shpejtë dhe më ekonomike, duke humbur më pak kohë dhe duke shpenzuar më pak mjete financiare.

Gjithashtu, me këtë mënyrë të publikimit të informatave të kërkuara / të dhëna pritet të zvogëlohet numri i kërkesave për qasje të lirë, dhe me këtë edhe detyrimi i poseduesve të informatave për të vepruar sipas të njëjtave.